



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 nëntor 2011
Nr. ref.: RK162 /11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 24/09

Parashtruesi

Shaqir Prevetica

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit CI. nr. 46/02 të Gjykatës Komunale të Prishtinës, të datës 10 shtator 2002; Vendimit Ac. 592/2002 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, të datës 1 shkurt 2005; Vendimit CI. nr. 130/05 të Gjykatës Komunale të Prishtinës, të datës 6 qershor 2005; Vendimit Ac. nr. 56/2006 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të datës 21 nëntor 2007 dhe Vendimit CI. nr. 05/08 të Gjykatës Komunale të Prishtinës, të datës 1 prill 2009.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi është Shaqir Prevetica, me banim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin CI. nr. 46/02 të Gjykatës Komunale të Prishtinës, të 10 shtatorit 2002; Vendimin Ac. 592/2002 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të 1 shkurtit 2005; Vendimin CI. nr. 130/05 të Gjykatës Komunale të Prishtinës, të 6 qershorit 2005; Vendimin Ac. nr. 56/2006 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të 21 nëntorit 2007 dhe Vendimin CI. nr. 05/08 të Gjykatës Komunale të Prishtinës, të 1 prillit 2009, në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij në kompensimin e marrëdhënies së punës.

Objekti i çështjes

3. Çështja ka të bëjë me shkeljet e pretenduara të të drejtave të parashtruesit për kompensim në marrëdhënie pune që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të përmendura më lart.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 20 i Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Më 1 korrik 2009, parashtruesi, përmes postës, ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata) një kërkesë lidhur me procedurat e gjykatave të përmendura në lidhje me procedurat që ai i ka nisur kundër Kompanisë Hoteliere Turistike "Kosova", në Prishtinë.
6. Kryetari i Gjykatës e emëroi gjyqtarin Altay Suroy për Gjyqtar raportues dhe emëroi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
7. Më 11 janar 2010, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë kopjen e aktpadisë për kompensimin e dëmit në vlerë prej 66,348 Euro kundër të paditurës-Kompania Hoteliere Turistike "Kosova", në Prishtinë, e paraqitur pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe urdhëresën e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës SCC-0112, të 13 korrikut 2009, me të cilën kërkohet që parashtruesi të rregullojë padinë dhe të bashkëngjisë dëshmitë.
8. Më 17 dhjetor 2010, Gjykata mbajti shqyrtimet përfundimtare lidhur me kërkesën.

Përmbledhja e fakteve

9. Bordi i Drejtorëve i Kompanisë Hoteliere Turistike "Kosova", në Prishtinë, me Vendimin nr. 177 të 12 dhjetorit 2001, ia ka lejuar parashtruesit të drejtën për asistencë sociale që nga 1 shkurti 2002, në shumën prej 70% të mesatares së të ardhurave personale në atë kompani në pritje të zgjidhjes përfundimtare të pensionit të ligjshëm nga institucioni shtetëror përkatës.
10. Më 10 shtator 2002, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Vendimin CI. nr. 46/02, e hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e parashtruesit kundër Vendimit nr. 177, të 12 dhjetorit 2001, të Kompanisë Hoteliere Turistike "Kosova", në Prishtinë.

11. Më 1 shkurt 2005, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Vendimin Ac. 502/2002, e vlerësoi kërkesën e parashtruesit të bazuar dhe e dërgoi rastin në Gjykatën Komunale për rigjykim.
12. Më 6 qershor 2005, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Vendimin CI. nr. 130/05, e refuzoi padinë e parashtruesit për shkak të vonesës.
13. Më 21 nëntor 2007, Vendimi Ac. nr. 56/2006 i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë e anuloi vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe ktheu rastin në gjykatën e instancës së parë për shqyrtim.
14. Më 1 prill 2009, Vendimi CI. nr. 05/08 i Gjykatës Komunale në Prishtinë suspendoi procedurat pasi Kompania Hoteliere Turistike "Kosova", në Prishtinë, ishte privatizuar dhe likuidimi i saj përfundoi më 11 prill 2007.
15. Parashtruesi u ankua ndaj këtij vendimi dhe çështja tani është në pritje në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi në kërkesën e tij kërkon nga Gjykata që të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimeve të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, përmes të cilave, sipas pretendimeve të tij, janë shkelur të drejtat e tij në kompensimin e marrëdhënies së punës. Sidoqoftë, ai nuk e ka bazuar kërkesën e tij duke iu referuar ndonjë neni të veçantë të Kushtetutës.
17. Parashtruesi pohon se vendimet e Gjykatës Komunale në Prishtinë: CI. nr. 46/02 i 10 dhjetorit 2002; CI. nr. 130/05 i 6 qershorit 2005; dhe CI. nr. 05/08 i 1 prillit 2009, dhe vendimet e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë: Ac. 592/2002 i 1 shkurtit 2005 dhe Ac. nr. 56/2006 i 21 nëntorit 2007, kanë vonuar vendimmarrjen për meritat.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruar, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë që parashihen me Kushtetutë, po ashtu dhe me ligj dhe Rregullore të punës.
19. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që parasheh:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Dhe nenit 47.2 të Ligjit që përcakton se:

"Individët mund ta ngrisin kërkesën në fjalë vetëm pasi që të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

20. Kërkesa e parashtruesit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë është ende në pritje dhe nuk është dhënë ende vendimi përfundimtar. Atje u ngritën një sërë faktesh në lidhje me progresin e rastit të parashtruesit në gjykata, në bazë të privatizimit të ish-ndërmarrjes së vet. Ai privatizim është finalizuar në vitin 2007.

21. Siç theksohet në rastin nr. KI 41/09 Universiteti AAB-RIINVEST kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës (Aktvendimi nr. RK-04/10 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 27 janar 2010), Gjykata dëshiron të theksojë që arsyetimi për rregullin e shterimit, siç interpretohet nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (shih neni 53 i Kushtetutës), është që tu ofrojë palëve kompetente, përfshirë këtu edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose përmirësuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik në Kosovë do të sigurojë mjete efikase ligjore për shkeljen e të drejtave kushtetuese.
22. Për më shumë, në kërkesë, parashtruesi nuk ka argumentuar pse ai konsideron që mjetet ligjore nuk do të jenë në dispozicion, dhe nëse po, nuk do të ishin efektive dhe rrjedhimisht nuk do duhej të shteroheshin.
23. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që parasheh si në vijim:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.
24. Parashtruesi në shkresat e tij nuk ka përmendur, ose nuk ka qartësuar, cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë shkelur.
25. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), që parasheh:

“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj”.
26. Gjykata Kushtetuese është e vetëdijshme për obligimin e vet për të interpretuar të drejtat kushtetuese në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të KEDNJ. Rasti i parashtruesit nuk mund të konsiderohet si i tejkaluar dhe i paarsyeshëm që nga momenti kur konsiderohen një sërë faktesh që janë ngritur nga privatizimi i Kompanisë Hoteliere Turistike “Kosova”, në Prishtinë, që u finalizua në vitin 2007.
27. Në këto rrethana, parashtruesi nuk konsiderohet se ka përmbushur kërkesat sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, respektivisht, ai nuk ka shteruar të gjitha mjetet ligjore.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe nenin 56(2) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA REFUZOJË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani